

BULETINI MUJOR

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

www.ild.al | info@ild.al



Inspektori i Lartë i
Drejtësisë



Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani
@ILD_Albania

ILD ANËTARE ME TË DREJTA TË PLOTA E RESIJ



EUROPEAN NETWORK
OF JUSTICE INSPECTION
SERVICES



MINISTÈRE
DE LA JUSTICE
*Liberté
Égalité
Fraternité*



Ministero della Giustizia



CONSEJO GENERAL
DEL PODER JUDICIAL
Servicio de Inspección



CSM
CONSELHO SUPERIOR DA MAGISTRATURA



ILD
INSPEKTORI I LARTË
I DREJTËSISË



ILD ANËTARE ME TË DREJTA TË PLOTA E RESIJ

Prej dates 19.10.2023, Inspektori i Lartë i Drejtësisë është anëtar me të drejta të plota i Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë (RESIJ) është një qëllim i përbushur për ne, pasi Rrjeti përbëhet vetëm nga vende të Bashkimit Evropian dhe pas një pune 2 vjeçare me statusin e vëzhguesit, tashmë ILD është anëtar me të drejta të plota.

Cfarë është RESIJ?

Në 2017, përfaqësues të shërbimeve të inspektimit të 14 vendeve anëtare të Bashkimit Evropian por jo vetëm, ranë dakord për

ndërtimin e Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë (RESIJ) për të ndërtuar bashkëpunim konkret mes tyre.

Ky rrjet synon:

- identifikimin e çështjeve dhe kryerjen e trajnimeve të përbashkëta në nivel Evropian; rritjen e rolit të shërbimeve kombëtare të inspektimit në cilësinë, efektivitetin dhe nivelin Evropian të Drejtësisë;
- sikurse edhe vlerësimin e instrumentave evropianë të asistencës së përbashkët gjyqësore në çështjet civile dhe penale;

bashkëpunimin për financime nga Bashkimi Evropian dhe nga Këshilli i Evropës për një numër iniciativash të lidhura me proceset e punës së shërbimeve të inspektimit të shteteve anëtare të RESIJ;

- hartimin e dokumenteve standarde në lidhje me ushtrimin e aktivitetit të inspektimit ose të atyre në lidhje me etikën e inspektorëve.

Në takimin e 10 dhjetorit 2021 të RESIJ, u vendos që institucioni i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, të Republikës së Shqipërisë, të ishte pjesë e këtij rrjeti Evropian me statusin e vëzhguesit.

Në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të RESIJ që u zhvillua sot online, të gjithë anëtarët, nga vende të Bashkimit Evropian, në mënyrë unanime vendosën të ndryshonin statusin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nga vëzhgues në anëtar me të drejta të plota.

Asambleja e ardhshme e RESIJ do të mbahet në Tiranë më 14 Dhjetor dhe mikpritet nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.



ILD

INSPEKTORI I LARTË
I DREJTËSISË

Rrjeti Evropian të Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë (RESIJ)

Në 2017, përfaqësues të shërbimeve të inspektimit të 14 vendeve anëtare të Bashkimit Evropian por jo vetëm, ranë dakord për ndërtimin e Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë (RESIJ) për të ndërtuar bashkëpunim konkret mes tyre. Ky rrjet synon: identifikimin e çështjeve dhe kryerjen e trajnimeve të përbashkëta në nivel Evropian; rritjen e rolit të shërbimeve kombëtare të inspektimit në cilësinë, efektivitetin dhe nivelin Evropian të Drejtësisë; sikurse edhe vlerësimin e instrumentave evropianë të asistencës së përbashkët gjyqësore në çështjet civile dhe penale etj.,



PËRFUNDON INSPEKTIMI TEMATIK NË DY GJYKATA TË TIRANËS PËR PROCEDURËN E SHPALLJES DHE ARSYETIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka përfunduar inspektimin tematik “Mbi procedurën e shpalljes dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksioni i Përgjithshëm Tiranë, (dhoma civile) dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”, për periudhën 1 shtator deri në 31 dhjetor 2022.

Ky inspektim është pjesë e planit të Inspektimeve të ILD-së për vitin 2023, në ushtrim të funksionit të kryerjes së inspektimeve institucionale e tematike mbi çdo aspekt të punës së gjykatave, administratës gjyqësore, zyrave të prokurorive dhe administratës së Prokurorisë.

Nga inspektimi ka rezultuar se në periudhën e inspektimit shtator-dhjetor 2022, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, 93.5% e totalit të vendimeve të shpallura janë arsyetuar dhe depozituar në sekretari brenda afatit

ligjor 7 ditor. Vendime të tjera janë dorëzuar brenda 10, 18 ditëve dhe 1 vendim është dorëzuar brenda 107 ditëve.

Nga inspektimi tematik në Gjykatën e Shkallës së Parë Juridiksioni i Përgjithshëm Tiranë, rezulton se numri total i çështjeve në këtë Gjykatë për vitin 2020 është 34 382 çështje. Gjykata ka 39 gjyqtarë nga 76 të parashikuar në dekret. Ngarkesa mesatare e një gjyqtari në Gjykatën e Shkallës së Parë Juridiksioni i Përgjithshëm Tiranë është 1361 çështje në vit. Në periudhën e verifikuar 1 shtator deri në 31 dhjetor 2022, rezulton se në Gjykatën e Shkallës së Parë Juridiksioni i Përgjithshëm Tiranë janë dorëzuar 1631 vendime brenda afatit 20 ditor, ndërsa jashtë afatit janë 981 vendime.

Pra konstatohet se pavarësisht afateve të parashikuara në ligjin procedural civil (neni 308 i KPC), këto afate në shumicën e rasteve nuk janë

zbatuar me rigorozitet nga ana e gjyqtarëve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

Megjithate, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, çmon se duke patur parasysh vakancat e theksuara (jashtë të zakonshmes), të gjyqtarëve në gjykata dhe numrin e madh të çështjeve në pritje për t'u shqyrtuar, duhet të tregohet një qasje sa më e kujdesshme. Ngarkesa në punë që shoqëron sot magjistratët, edhe për shkak të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, është një kriter objektiv, që mbahet parasysh me numrin total të çështjeve civile dhe kohën e nevojshme për të arsyetuar vendimet gjyqësore të dhëna.

Në konsideratë të sa më sipër, Inspektori i Lartë i Drejtësisë vlerëson, se jo në çdo rast, mosrespektimi i afateve të përcaktuara nga ana e legjislacionit procedural dhe në mënyrë të veçantë, afatet e parashikuara për të dorëzuar brenda një afati të arsyeshëm vendimet e arsyetuara, do të konsiderohen si shkelje e mundshme disiplinore. Që këto shkelje të konsiderohen si të tilla, duhet të ketë një mungesë kujdesi dhe operativiteti, neglizhencë apo mungesë aftësie profesionale, të tilla që kalojnë "kufirin e të arsyeshmes" dhe që një sjellje e tillë nuk mund të justifikohet nga ana e magjistratit. Vonesa në arsyetimin dhe dorëzimin e vendimeve përbën shkelje disiplinore gjithashtu kur përbën rast përsëritës, të rëndë dhe të pajustificuar, si dhe kur nuk ka ardhur si pasojë e ndonjë shtate, që është jashtë kontrollit të magjistratit dhe që mund të lidhet me mosfunksionimin e sistemit gjyqësor.

Në këtë kuadër, për të arritur në konkluzionin, nëse nga ana e magjistratëve janë ndërmarrë veprime/mosveprime, të cilat mund të përbëjnë shkelje disiplinore apo veprimi/mosveprimi

lidhet me veprimtarinë e tyre profesionale, duhet të analizohen rast pas rasti, nëpërmjet një procesi verifikimi apo hetimi disiplinor, të gjitha rastet ku afati i arsyetimit dhe dorëzimit të vendimit gjyqësor tejkalon afatin, i cili konsiderohet si një "kohë e arsyeshme", që i nevojitet gjyqtarit/

gjykatës të dorëzojë vendimin përfundimtar të arsyetuar.

Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezulton se 89 % e vendimeve janë dorëzuar brenda afatit 120 ditor, duke u konsideruar kështu në shumicën e rasteve, si koha e arsyeshme, që i nevojitet gjyqtarit/gjykatës, të dorëzojë vendimin përfundimtar të arsyetuar. Pra, vetëm për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe vetëm për periudhën e inspektimit, 1 shtator deri në 31 dhjetor 2022, Inspektori i Lartë i Drejtësisë vlerëson se për efekt të vlerësimit, nëse ka shkelje disiplinore, koha e arsyeshme që i nevojitet gjyqtarit/gjykatës të dorëzojë vendimin përfundimtar të arsyetuar, është 120 ditë.

Bazuar në këtë arsyetim dhe analizë, në raportin e inspektimit rekomandohet:

Fillimi i verifikimeve në kuadër të ligjit me nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për të konstatuar nëse ka fakte të mjaftueshme për fillimin e hetimit disiplinor:

– për magjistrat gjyqtar të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për vendimin e shpallur, i cili është depozituar i arsyetuar në sekretari brenda 107 ditëve nga shpallja;

– për magjistrat gjyqtar të Gjykatës Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për vendimet e shpallura e të dorëzuara të arsyetuara në sekretari pas 120 ditëve nga shpallja

- dhe për magjistrat gjyqtar të Gjykatës Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për vendimet e shpallura e të pa dorëzuara në sekretari deri në datën 15.05.2023.

[Raportin e plotë të këtij inspektimi tematik mund ta lexoni këtu.](#)



INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË TRYEZË BASHKËBISEDIMI ME SHOQËRINË CIVILE TË LEZHËS

Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani zhvilloi një tryezë bashkëbisedimi me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, që veprojnë në bashkinë e Lezhës.

Takimi i mbështetur nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, është pjesë e strategjisë së komunikimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për paraqitjen e institucionit tek grupet e ndryshme të interesit, aty ku ata jetojnë, edhe jashtë kryeqytetit, si dhe diskutuar me ta mbi mënyrën se si e shohin rolin e institucionit, eksperiencat dhe pritshmëritë në raport me sjelljen e magistratëve në sistem. Ky komunikim direkt ndihmon në rritjen e transparencës, por edhe të efikasitetit të punës së ILD-së, e më tej në rritjen e forcimit të besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Metani paraqiti

rolin e ILD-së, si institucioni përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve në vend dhe iu përgjigj interesit të pjesëmarrësve mbi aspekte të veçanta të punës, por edhe të sistemit të drejtësisë.

“Reforma në drejtësi ka nevojë të transmetojë tek qytetarët rëndësinë e zbatimit të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, si i vetmi standard që garanton të ardhmen e pavarësisë së sistemit të drejtësisë. Transparenca dhe komunikimi i hapur mbeten thelbësore për të rritur e forcuar besimin e publikut tek puna e institucioneve. Kjo është arsyeja pse ILD i kushton kohë dhe vëmendje ndërveprimit me qytetarë e grupe interesi, si përmes zyrës së ankesave në institucion, ashtu edhe përmes takimeve direkte, siç është kjo tryezë bashkëbisedimi, që po na provon se sa të



nevojshme janë kontakte të tilla”, tha mes të tjerash të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. z. Metani.

Një diskutim i hapur u zhvillua mbi mënyrën se si funksionon procesi i ankimit pranë ILD-

së dhe pritshmëritë e pjesëmarrësve, bazuar edhe në eksperiencat konkrete. Në diskutim u përfshinë edhe inspektorë, ndihmës inspektorë dhe punonjës të zyrës së ankesave e marrëdhënieve me publikun

Përfaqësuesit e Prezencës së OSBE-së, z. Mauro Puzzo dhe znj. Luljeta Krasniqi vlerësuan se Prezenca ka kënaqësinë të mbështesë projekte të tilla të komunikimit të hapur të institucionit me shoqërinë civile, si një dimension i rëndësishëm i demokracisë pjesëmarrëse dhe rritjes së besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.



ILD në Twitter



Inspektori i Larte i Drejtesise Ar...

@ILD_Albania

Follow



Inspektori i Larte i Drejtesise Ar...

@ILD_Albania

Follow

📍Rrjeti European i Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë ⚖️🇪🇺 (RESIJ) mirëpret ILD 🇲🇰 si anëtare me të drejta të plota në Rrjet! Faleminderit kolegëve të mi të vendeve të BE-së për vendimin dhe mbështetjen për Shqipërinë! Shihemi në Tiranë në Dhjetor!

[Translate post](#)

Po ndodh: Diskutime shume interesante me studentet e Akademise se "Citizen in charge" mbi Zyren e ILD-se por edhe sfidat e sistemit te drejtesise. @q_ytetares #ILD ⚖️



4:54 PM · Oct 16, 2023 · 213 Views



Inspektori i Larte i Drejtesise Ar...

@ILD_Albania

Follow



Inspektori i Larte i Drejtesise Artur Metani

@ild_albania · 11 Tet



📍Po ndodh: Tryezë bashkëbisedimi me OJF të Lushnjës mbi rolin e ILD-së në verifikimin e ankesave, hetimin e procedimit disiplinor të magjistratëve. #ILD -@OSCEinAlbania #komunikim #publiku #drejtësia



11:09 AM · Oct 11, 2023 · 345 Views

Procesi i ankimimit, hetimit apo edhe procedimit disiplinor i shërbejnë llogaridhënies së magjistratëve, por edhe vendosjes e garantimit të standardeve më të mira të drejtësisë! 📌



1 Twitter



Inspektori i Larte i Drejtesise Artur Metani

@ild_albania · 11 Tet



Diskutime efektive me përfaqësues të shoqërisë civile të Lushnjës mbi rolin e funksionet e #ILD-së si dhe administrimin e drejtësisë e pavarësinë e magjistratëve. 🙏 @OSCEinAlbania



1 Twitter

TETORI NË ILD ME SHIFRA

Gjatë muajit **Tetor** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **61 ankesa**, nga të cilat 58, të paraqitura nga qytetarët dhe 3 nga institucione.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion gjatë muajit **Tetor 2023**. Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët dhe ndodhen në faza të ndryshme, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

VERIFIKIME

24 vendime verifikimi, nga të cilat:

- ⇒ **23 vendime verifikimi (praktika të ILD-së);**
- ⇒ **1 vendim verifikimi (dosje të mbartura nga ish KLD);**

HETIME DISIPLINORE

- **1 vendim për fillim hetimi disiplinor për 1 magjistrat**
- **1 vendim për vazhdim hetimi disiplinor për 2 magjistratë**

ARKIVIME

125 vendime arkivimi nga 262 praktika të shqyrtuara, konkretisht:

- ◆ **92 vendime arkivimi pas verifikimit nga praktika të ILD, nga të cilat:**
 - ⇒ **64 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar;**
 - ⇒ **28 vendime arkivimi pas verifikimit;**
- ◆ **33 vendime arkivimi nga praktika të trajtuara (dosje të mbartura nga ish KLD):**
 - ⇒ **4 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar;**
 - ⇒ **29 vendime arkivimi pas verifikimit.**



Gjatë asistimit të ankuesve

Ekipi i zyrës së ankesave pret qytetarë-ankues çdo ditë pune nga ora 09.00-14.00, ndërsa për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas komunikimit përmes faqes dhe adresës zyrtare. Zyra e

Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.

Pjesë e ekipit është edhe Koordinatori për të drejtën e informimit.



Gjatë muajit Tetor 2023, Sektori i Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun ka pritur 27 ankues, të cilët janë paraqitur në ambientet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe 24 telefonata me qytetarë, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre ose Informacion mbi plotësimin e formularit TIP të ankesës.



KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Në përputhje me parimet dhe rregullat e parashikuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, koordinatori për të drejtën e informimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i mundëson çdo kërkuar të drejtën për t’u njohur me informacionin publik, si dhe komunikon sipas nevojës me kërkuar për trajtimin e kërkesës për informacion publik.

Kërkesa për informacion depozitohen nga qytetarët, personat juridikë, grupet e

interesuara, nëpërmjet Postës Shqiptare Sh.a., postës elektronike në adresën: info@ild.al, si dhe asaj të koordinatorit për të drejtën e informimit amanta.jasa@ild.al.

Informacionet e parashikuara në programin e transparencës publikohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar ligjor.

SHIFRA MUJORE

Gjatë muajit Tetor 2023, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur 16 kërkesa për informacion, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda 5 ditëve, (ligji parashikon që kërkuarit t’i kthehet përgjigje brenda 10 ditëve).

ANKIMI NË ILD

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vijon me intensitet punën për konfirmimin e ankesave të mbartura e atyre të administruara që prej 1 Shkurtit 2020, kur u ngrit si institucion. Për të lehtësuar këtë proces për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posacëm ankese, i cili:

- * mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- * të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në info@ild.al ose me postë në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr.13, Tiranë.


* mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD, në rast nevojë, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD www.ild.al, në seksionin “Si pranohen ankesat”.

SHPLLJE PUBLIKE E VENDIMEVE

Edhe gjatë muajit **Shtator** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka bërë shpalljen publike të vendimeve të arkivimit, për **23 ankues**, edhe **1 për ish-magjistrat** të cilët kanë rezultuar të paarrtshëm në adresat e komunikuar prej tyre. Përveçse në stendat e ILD-së, sipas ligjit këto shpallje gjenden edhe në faqen tonë zyrtare dhe të afishuara edhe në stendat e bashkive nga vijnë ankuesit. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në total ka bërë ka bërë **337 shpallje publike**.





INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË ZHVILLOI NJË LEKSION TË HAPUR ME STUDENTËT E AKADEMISË “CITIZEN IN CHARGE”

Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani funksionet dhe sfidat e veprimtarisë së ILD-së, zhvilloi një leksion të hapur me studentë të juridikut e shkencave politike, pjesëmarrës në Akademinë “Citizen in charge” të organizatës “Qëndresa Qytetare”.

Z. Metani mbajti temën “Roli i inspektorit të Lartë të Drejtësisë në arkitekturën e re të sistemit të drejtësisë dhe angazhimi qytetar në shoqërinë e së drejtës.”, duke shpjeguar Duke iu përgjigjur interesit të studentëve për aspekte të ndryshme të punës së ILD-së, por edhe për problematika në sistemin e drejtësisë në përgjithësi, z. Metani evidentoi filozofinë e





punës së institucionit që drejton, që është gjetja e balancës mes interesit publik, qytetar për mënyrën sesi administrohet drejtësia dhe respektimit të pavarësisë së magistratëve.

“Të dyja janë njëlloj të rëndësishme, vërejtje Inspektori i Lartë i Drejtësisë, së pari duhet të kup-

tohet që pavarësia e magistratëve shoqërohet me llogaridhënie. Vetë sistemi duhet të jetë llogaridhënës, sepse pavarësia nuk është privilegj, por është përgjegjësi. Nga ana tjetër, edhe mënyra sesi i jepet zë interesit publik është shumë delikate, pasi sistemi nuk mund të ketë sukses, nëse nuk i krijojmë mjedis demokratik,





nëse nuk e mbështesim.”

I pyetur për pritshmëritë dhe ndjeshmëritë e qytetarëve nga reforma në drejtësi, z. Metani nënvizoi sërish rëndësinë që ka të kuptuarit se demokracia dhe sundimi i ligjit janë të lidhura bashkë dhe se përgjegjshmëria qytetare është kontribut për demokratizimin shoqëror.

“Reforma në drejtësi do kohë që të japë efektet e veta. Padyshim që ka elementë pavarësie dhe kjo është e dukshme e duhet inkurajuar. Sepse

pavarësi është edhe kur të pëlqen një vendim gjyqësor, por edhe kur nuk të pëlqen. Duhet të mësohemi ta pranojmë këtë. Kjo është kulturë ligjore por edhe demokratike. Nga ana tjetër, sa i takon njerëzve të sistemit, të jesh i pavarur, ka shumë elementë në vetvete, që nisin që nga formimi i përgjithshëm gradual ndër vite, pra investimi me dije që ndihmojnë në plotësimin e figurës profesionale të individit, sepse duhet kuptuar që drejtësia është cilësi.”, tha z. Metani.





METANI BASHKËBISEDUI ME PËRFAQËSUES TË SHOQËRISË CIVILE TË LUSHNJËS

Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani i shoqëruar nga anëtarë të ekipit të ILD-së zhvilloi një tryezë bashkëbisedimi me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, që veprojnë në bashkinë e Lushnjës.

Kjo është tryeza e dytë që zhvillohet nën kujdesin e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, si pjesë e strategjisë së komunikimit të Zyrës së ILD-së, për të paraqitur rolin dhe funksionet e institucionit tek grupet e ndryshme të interesit, aty ku ata jetojnë e veprojnë, edhe jashtë kryeqytetit.

Në fjalën hyrëse, Inspektori i Lartë i Drejtësisë vërejtë se ky komunikim direkt me grupe interesi mbi mënyrën se si e shohin rolin e institucionit, eksperiencat apo edhe pritshmëritë nga sistemi i drejtësisë, ndihmon edhe vetë ILD-në në rritjen e efikasitetit në punë, transparencën e natyrisht edhe forcon besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë.

Pasi paraqiti funksionet e ILD-së, si institucioni përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e





shkeljeve disiplinore dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve në vend, z. Metani dhe ekipi i tij, iu përgjigjën pyetjeve të të pranishmëve mbi modalitete të punës së institucionit, sistemin e ankimit dhe procedimit disiplinor, por edhe sfidave të sistemit të drejtësisë për të fituar besimin e qytetarëve.

Z. Metani u ndal tek puna e ILD-së për të gjetur balancën e duhur mes interesit të publikut për administrimin e drejtësisë dhe pavarësisë së

magjistratëve. “Inspektori i Lartë i Drejtësisë punon fort për të fituar edhe besimin e magjistratëve, përveçse të publikut përmes veprimtarisë së vet. Është shumë e rëndësishme që magjistratët të kuptojnë se procesi i ankimit, hetimit apo edhe procedimit disiplinor i shërbejnë llogaridhënies por edhe vendosjes e garantimit të standardeve më të mira të drejtësisë, të cilat janë jo vetëm detyrim ligjor, por edhe në raport me pritshmëritë publike, jo thjesht për të zgjidhur “hallin e sotëm” por për t’i shërbyer sistemit në nivel afatgjatë. “, u shpreh z. Metani.





Përfaqësuesit e Prezencës së OSBE-së, z. Cailean Maclean dhe znj. Luljeta Krasniqi vlerësuan se eficientën e këtij komunikimi të hapur të ILD-së me shoqërinë civile me mbështetjen e Prezencës.

“Qëllimi i OSBE-së në mbështetjen për reformën në drejtësi nuk është vetëm rishikim legjislativ dhe organizim trajnimesh. Është në fakt edhe mbështetja dhe fuqizimi i procesit të afrimit të sistemit të drejtësisë me publikun, në mënyrë që të rritet besimi i qytetarëve tek gjyqësori. Nuk ka asnjë institucion më qendror për këtë sesa In-

spektori i Lartë i Drejtësisë. Ky është institucioni që siguron një sistem drejtësie të besueshëm, kompetent dhe të përgjegjshëm për të gjithë shqiptarët.”, u shpreh z. Cailean Maclean, shef i Departamentit të Sundimit të Ligjit dhe të Drejtave të Njeriut.

Bashkëbisedimi me organizata të shoqërisë civile edhe jashtë Tiranës është pjesë e strategjisë së komunikimit, që Inspektori i Lartë i Drejtësisë e ka nisur më herët, me studentë të degës së drejtësisë në universitete të ndryshme të vendit.





PËRPUNIMI STATISTIKOR I ANKESAVE NË KOHË REALE, SFIDA E RE E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË


Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë po konsolidon procesin e trajtimit të ankesave/ cështjeve në institucion, më qëllim sigurimin e informacionit transparent dhe në kohë reale, që do i shërbejë lehtësimit të procesit të analizimit dhe raportimit periodik të institucionit.

Gjatë një takimi pune me ekipin e inspektorëve, ndihmës inspektorëve, Sekretarin e Përgjith-

shëm, kabinetin dhe nëpunës të administratës u bë prezantimi i paketës së dokumentacionit për grumbullimin dhe përpunimin e informacionit statistikor lidhur me shqyrtimin e ankesave.

Në fjalën e tij, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani theksoi se grumbullimi i informacionit statistikor duhet të prodhojë analizë të plotë mbi problematikat që dalin nga shqyrtimi i an-





kesave, me qëllim rritjen e standardeve të punës. Z. Metani u shpreh se Zyra e ILD-së synon ngritjen dhe forcimin e praktikave e standardeve më të mira të punës, për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë dhe efencës së cdo sektori të institucionit.

Pjesë e paketës së dokumentacionit për grumbullimit dhe përpunimin e informacionit statistikor lidhur me shqyrtimin e ankesave është edhe

Platforma e regjistrimit (Aplikacioni Lists), e cila siguron regjistrimin në kohë reale të informacionit të ankesave/çështjeve kryesisht, sigurimin e transparencës dhe aksesit gjatë fazave të shqyrtimit të tyre, për të gjitha strukturat e përfshira në proces, grumbullimin e informacionit të plotë statistikor në bazën e të dhënave me qëllim përpunimin, analizimin dhe përgatitjen e raporteve, buletineve periodike etj.





ILD FORMAT I STANDARDIZUAR TË PËRMBAJTJES DHE MËNYRËS SË ARSYETIMIT LIGJOR TË PROJEKTVENDIMEVE

Me njësinë e Inspektorëve dhe ndihmës-Inspektorëve të ILD diskutuam mbi formatet e standardizuara të përmbajtjes dhe mënyrës së arsyetimit ligjor të projektvendimeve në faza të ndryshme të shqyrtimit të ankesave, sa i takon përmbajtjes dhe mënyrës së arsyetimit ligjor.

Synimi i diskutimit ishte përkimi me praktikën e

punës së Këshillave dhe të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

Në këtë kuadër trajtojmë edhe propozime për standardizimin e rasteve të tjera, që mund të kërkojnë një unifikim në mënyrën e arsyetimit ligjor bazuar në praktikën e evidentuara të punës në ILD.



TETOR 2023

Të gjitha të drejtat e rezervuara Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

© ILD




KONTAKT ILD

WEB: ild.al
EMAIL: info@ild.al
ADRESA: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”,
 Godina nr.13 Tiranë, Shqipëri



Spot prezantues ILD
 Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë
[youtube.com](https://www.youtube.com)

*Kliko për të ndjekur spotin
 prezantues të ILD*



Më skano!